



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.47/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Angjelina Krasniqi nga Shoqata sindikale e KRU-Hidrodrini, me seli në Pejë, paraqitur kundër Ardit Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.09.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZLAnr.47/2025, e datës 19.09.2025, parashtruar nga Angjelina Krasniqi nga Shoqata sindikale e KRU-Hidrodrini, me seli në Pejë, paraqitur kundër Ardit Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 19.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë përmes postës nga Angjelina Krasniqi nga Shoqata sindikale e KRU-Hidrodrini, me seli në Pejë, paraqitur kundër Sekretarit të përgjithshëm të ndërmarrjes publike KRU Hidrodrini SH.A, Ardit Berisha, njëherit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke përdorur pozitën publike për fushatë personale.

Më tej në ankesë thuhet se kandidati në fjalë ka shfrytëzuar ambientet e zyrës në punë si burime dhe institucione publike shtetërore, për qëllime elektorale.

Parashtruesja e ankesës thekson se pozita të cilën mbanë kandidati është pozitë që ndikon direkt në presion tek punëtorët, duke krijuar frikë, pasiguri, ndasi, përçarje brenda punëtorëve të ndërmarrjes gjatë fushatës zgjedhore .

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.09.2025, të subjektit politik LVV theksohet se Znj. Angjelina Krasniqi, në ankesën e dorëzuar, pretendon se z. Ardit Berisha, kandidat për asamblë, ka shfrytëzuar pozitën zyrtare në KRU Hidrodrini Sh.A. dhe ambientet e punës për veprimtari zgjedhore. Ky pretendim bie ndesh me faktet dhe dispozitat ligjore.

Z. Ardit Gashi, ka marrë pushim pa pagesë gjatë gjithë periudhës së fushatës dhe ka caktuar zëvendësues për ushtrimin e detyrave të tij, duke informuar Kryeshefin Ekzekutiv. Prandaj, gjatë kohës së fushatës ai nuk ka ushtruar detyrën e Sekretarit dhe as nuk ka përdorur resurset e ndërmarrjes.

Në aspektin juridik, neni 36 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe neni 6 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 ndalojnë shfrytëzimin e zyrës, resurseve apo pasurisë publike për qëllime të fushatës. Në këtë rast nuk ekziston asnjë provë që të dëshmojë përdorim të tillë. Përkundrazi, kandidati është tërhequr nga funksioni për të shmangur çdo konflikt interesi. Vet fakti se mban pozitë në një ndërmarrje publike nuk përben shkelje, përderisa nuk provohet përdorimi i resurseve për fushatë.

Më tej në përgjigje theksohet se pretendimi i znj. Krasniqi është i pabazuar dhe nuk mbështetet në prova. Përkundrazi, veprimet e ndërmarra nga kandidati i LVV-së, dëshmojnë respektim të ligjit dhe transparencë institucionale.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, kërkohet nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa të refuzoj ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që paraqitësja e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi, dhe si e tillë nuk mund të vërtetohet se nga ana e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, Ardit Berisha është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje ne zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*.

Parashtruesja e ankesës Angjelina Krasniqi nga Shoqata sindikale e KRU-Hidrodrini, me seli në Pejë, në ankesën ZLA. nr.47/2025 të datës 19.09.2025, nuk ka bashkangjitur asnjë provë dhe nuk ka përcaktuar kohën se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe si e tillë nuk ka mundur të argumentoj në asnjë moment, në mënyrë të qartë dhe bindëse se në objektin e punës konkretisht në institucionin KRU Hidrodrini SH.A, Ardit Berisha, Sekretar i Përgjithshëm në këtë institucion, ka bërë shfrytëzimin e ambientit të zyrës duke përdorur pozitën publike për të zhvilluar fushatë për subjektin politik LVV, ashtu siç pretendon pala ankuese. Mirëpo një pretendim i tillë në mungesë të provave nuk është vërtetuar as nga ana e Panelit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga

veprimet e përshkruara në ankesë parashtresja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetohet se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.47/2025 më datë 20.09.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.